



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë/a:	03.03.2021
Referenc-ë:	07-353/04-38246/21
Për/ Za/ To:	“OJQ Flori”- Hava Abdullahu
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-38246/21 nga “OJQ Flori” me përfaqësuese Hava Abdullahu me të cilën kërkohet që me datë 5,6 dhe 7 Mars 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në Sheshin “Zahir Pajaziti” nga ora 09:00 deri në 18:00.

Qëllimi i panairit është promovimi i veshjeve Kombëtare, luleve dhe shumë gjëra të tjera të gjitha të punuara nga grat e “OJQ Flori”.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, i jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datat 6, 7 dhe 8 Mars 2021 në Sheshin “Zahir Pajaziti” sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Organizatori obligohet që të siguroj respektimin e plotë të gjitha masat e parapara nga IKSHPK për organizime të tilla në kohë pandemie. Organizatori obligohet që të siguroj dhe të monitoroj gjatë gjithë kohës së këtij organizimi që numri i pjesëmarrësve të jetë i kufizuar, të ketë distancë të mjaftueshme, secili pjesëmarrës ti bart masat mbrojtëse si dhe masa tjera të përcaktuar nga IKSHPK për mbrojtje nga COVID.
- Varësisht nga vendimet e IKSHPK-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

